



Duke u mbështetur në nenin 73 të Ligjit të Vetëqeverisjes Lokale Nr.03/L-040, nenit 28 të Statutit të Komunës së Klinës si dhe nenit 5,6 dhe 7 të Rregullores Komunale për Komitete Konsultative/2012, si dhe Vendimit për Shpallje të Konkursit publik për anëtarësimin në Komitete Konsultative me numër 01Nr.06-631/2018 të miratuar me 31.01.2018 dhe vendimit për vazhdim të Konkursit 01 Nr.06-3260/2018 të dt.27.04.2018 dhe sipas Propozimit të Listës së ngushtë të Panelit Intervistues për kandidatët për anëtarësim në komitete Konsultative të Komunës së Klinës të datës 22.10.2018, Kuvendi i Komunës së Klinës në seancën e IX-të të radhës për vitin 2018, të mbajtur më 26.10.2018, merr këtë:

V E N D I M

I

Miratohet, Propozimi i Listës së ngushtë për anëtarësim në Komitetet Konsultative të Komunës së Klinës nga Paneli Intervistues të datës 22.10.2018.

Në Komitetin për Bujqësi, zhvillim rural dhe mbrojtje të mjedisit zgjedhën:

1. Dukagjin Palushaj, Klinë
2. Fahredin Gashi, Sverkë
3. Martin Rrustemi, Gjurgjevik i Vogël
4. Luan Berisha, Dush
5. Shqipe Desku, Klinë

II

Organizimi, funksionimi si dhe kompetencat e këtij Komiteti janë të përcaktuara me dispozitat e Ligjit të Vetëqeverisjes Lokale, Nr. 03/L-040, Statutit të Komunës, Rregullores komunale për komitete Konsultative, si dhe dispozitat e Udhëzimit Administrativ Nr.01/2016.

III

Mandati i parë i anëtarëve të komiteteve konsultative është 4 vjeçar nga themelimi i komitetit dhe nuk mund të shërbejë me shumë se dy mandate të njëpasnjëshme.

Shkarkimi i anëtarëve behët me propozim nga Kryetari i Komunës konform nenit 9 të Rregullores Komunale për Komitete Konsultative.

IV

Komuna është e obliguar të ofrojë në dispozicion mjetet e nevojshme në menyrë që komiteti të këtë mundësi të kryej punën në mënyre efikase.

V

Komitetet mbajnë se paku gjashtë (6) takime në vit dhe kompensohen nga buxheti i komunës jo me shumë së për gjashtë (6) takime në vit.

VI

Vendimi është i plotfuqishëm me miratimin në Kuvendin e Komunës së Klinës konform nenit 81 të Ligjit Për Vetëqeverisje Lokale.

Me këtë vendim njoftohen: MAPL, Kryetari, anëtarët e Komiteteve Konsultative, Zyra Ligjore, Zyra e Informimit, Shërbimi për Punë të Kuvendit dhe Arkivi i Komunës.

KUVENDI I KOMUNËS KLINË

01Nr. 112-7167 2018
Klinë, më 01.11 2018

